



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUSHTRRI

03 Nr. / Br 755/16

Nr. i fq. / Br. sh - 1 -

01.08.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

VUEKryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 108/A të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe pas njoftimit të drejtorisë për prokurim dt. 01.08.2016 për nevojën e rishqyrtimit të aktiviteteve të prokurimit publik lidhur me tenderin "Mirëmbatja dhe Pastrimi i Objekteve të AK-Vushtrri", dt.01.08.2016 Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

### Për formim të Komisionit AD HOC për rishqyrtim të aktiviteteve të prokurimit publik

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesës për rishqyrtim të aktivitetit të prokurimit publik, në Drejtorinë për Prokurim Publik, në këtë përbërje:
  - 1.1 **Hyda Dallku**, kryesues
  - 1.2 **Liridon Lahu**, anëtar
  - 1.3 **Hashim Hajrizi**, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi obligohet që të shqyrtoj kërkesën e palës – "*Konzorciumi COMMANDO " sh.p.k dhe N.SH." BOSS -NETWORKS INC*", me seli në Prizren, për rishqyrtim të aktiviteteve të prokurimit publik në rastin e prokurimit Nr. 644-16-097-211 lidhur me tenderin "*Mirëmbatja dhe Pastrimi i Objekteve të AK-Vushtrri*",
3. Komisioni, me rastin e shqyrtimit të kërkesës duhet të bashkëpunoj ngushtë me Drejtorinë për prokurim dhe merr vendim konform dispozitave ligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje. Lidhur me vendimin duhet të njoftoj palën, branda afatit të përcaktuar ligjorë.
4. Ky komision ka mandat vetëm për këtë rast ankimor.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendi iu dërgohet: Drejtorit për Prokurim Publik, Anëtarëve të Komisioni, dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës  
  
Bajram Mulaku





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA VOJVODINA  
KOMUNA E VUSHTRRI - КОМУНА ВУШТРИ

02 Nr./Be 772/16

No. i fq./Bn. sh - 2 -

Data/ Datum 03.08.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Bazuar në nenin 1 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 4 paragrafi 2, pika 2.4, nënpika 2.4.3, nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në vendimin e kuvendit të komunës 01Nr.190/14 dt.29.09.2014, listën e projekteve kapitale për v. 2015 të miratuar në mbledhje të KK-së me datën 29.09.2014, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 02.08.2016 merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHPRONËSIM TË PRONAVE TË**  
**PALUEJTSHME**

**Neni 1**

Fillohet procedura e shpronësimit të pronave të paluejtshme të pronarëve privatë/zotëruesit të interesit, për qëllim të interesit publik – realizimi i projektit për ndërtimin me kubëza betoni i trotuarit në rrugën "Arsim Muzaqi" në Vushtri, Komuna Vushtri, për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

- P-70202016-01045-0, në sipërfaqe prej 23 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 430 m<sup>2</sup>, ZK-Vushtri, bashkëpronar në pjesë ideale 1/6 Staletovic Tatijana (Ratko), Petrovic Dosta (Dimitrije), Staletovic Liljana (Ratko), Zivkovic Radmila, Popadic Dragoljub (Dimitrije), Murganic Gordana (Zivojin), nga Vushtria, Komuna Vushtri.
- P-70202016-01046-0, në sipërfaqe prej 5m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 217 m<sup>2</sup>, ZK-Vushtri pronar me pjesë ideale 1/1 Blerim Krasniqi (Xhemajli) nga Vushtria, Komuna Vushtri.
- P-70202016-01047-0, në sipërfaqe prej 27m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 309 m<sup>2</sup>, ZK-Vushtri pronar me pjesë ideale 1/1 Murganic Dragisa (Blagoje), nga Vushtria, Komuna Vushtri.
- P-70202016-01048-0, në sipërfaqe prej 7m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 141 m<sup>2</sup>, ZK-Vushtri pronar me pjesë ideale 1/1 Arif Shatrani (Behrami), nga Vushtria, Komuna Vushtri.
- P-70202016-01049-0, në sipërfaqe prej 5m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 456 m<sup>2</sup>, ZK-Vushtri bashkëpronar me pjesë ideale 1/3 Jeset Rexhepi (Rrahmon), Izet Rexhepi (Rrahmon), Ismet Rexhepi (Rrahmon), nga Vushtria, Komuna Vushtri.

## Neni 2

Shpronësimi i pjesëve të parcelave kadstrale të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me kompensim, konform dispozitave të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

## Neni 3

Vlerësimin për kompensimin e shpronësimit e bën Zyra për Vlerësim të Pronës së paluajtshme pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.

## Neni 4

Me këtë vendim të njoftohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Urbanizmit, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe pronarët/zotëruesit e interesit të parcelave që do të shpronësohen.

## Neni 5

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga organi shpronësues.

Kryetari i Komunës  
Bajrami Milaku





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPSTINA VUČITRIN

03 Nr./Zr. 773/16

Nr. i fq./Bc. st. -10-

Data: / Datum 03.08.2016

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës të datës 03 gusht 2016 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës me datën **03 gusht 2016** merr këtë:

VENDIM

1. Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në shumën prej treqind e tetëdhjetë (380) euro nga fondi për transfere dhe subvencione për OJQ-në "Stand out", të cilën e përfaqëson zt. Blerim Ibrahim, me qëllim të organizimit të turneut në futboll për nder të 12 gushtit – Ditës së Rinisë.
2. Pagesa e mjeteve financiare të përmendura në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës  
  
Bajram Mulaku



Nga një kopje e këtij Vendimi iu dërgohet:  
-Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;  
-Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;  
-Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN	
03 No. / Br	774 / 16
No i lq. / Br. st	- 7 -
Data / Datum	03 08. 2016
VUSHTRRI - VUČITRAN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës të datës 03 gusht 2016 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës me datën **03 gusht 2016** merr këtë:

**VENDIM**

1. Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në shumën prej treqind (300) euro nga fondi për transfere dhe subvencione për OJQ-në "ATO", të cilën e përfaqëson znj. Fikrije Ferizi, me qëllim të organizimit të turneut për gratë e viseve rurale lidhur me njohjen e trashëgimisë kulturore të qytetit të Vushtrisë dhe qyteteve tjera të Kosovës, të cilat kanë trashëgimi të pasur kulturore.
2. Pagesa e mjeteve financiare të përmendura në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës  
  
Bajram Mulaku



Nga një kopje e këtij Vendimi iu dërgohet:  
-Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;  
-Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;  
-Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

62 Nr./Br. 782/16

Nr./Fq./Br. et - 1 -

Data / Datum 10.08.2016

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës të datës 08 gusht 2016 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës me datën **09 gusht 2016** merr këtë:

#### VENDIM

1. Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në shumën prej katërqind e dhjetë (410) euro nga fondi për transfere dhe subvencione për OJQ-në "LAPD", të cilën e përfaqëson z. Mehdi Ferati, me qëllim të organizimit të hulumtimit dhe publikimit rreth temës "Edukimi i të rinjve në parandalimin e përdorimit të duhanit".
2. Pagesa e mjeteve financiare të përmendura në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës  
  
Bajram Mulaku



Nga një kopje e këtij Vendimi iu dërgohet:  
-Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;  
-Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;  
-Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

02 Ng./Br: 784/16

Nr. l.fq./Br. sht: -1-

Data: / Datum: 12.08.2016

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të rekomandimit të z. Islam Islami – koordinator nga Komuna Vaxjo - Suedi, Kryetari i Komunës më datën **11 gusht 2016** merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë Vendim formohet Komiteti për Ndërmarrës për Komunën e Vushtrrisë për bashkëpunim me Komunën e Vaxjo-s nga Suedia në këtë përbërje:
  - 1.1.Arta Haxhaj – DEBPZHR;
  - 1.2.Abit Abiti – ZKF;
  - 1.3.Musaj Tërbunja – DA;
  - 1.4.Rreze Duli – AZHR;
  - 1.5.Zenel Bunjaku – IADK;
  - 1.6.Haki Rexhepi – BJ.
2. Komiteti në fjalë do të veprojë në emër të Komunës së Vushtrrisë lidhur me të gjitha format e partneritetit dhe bashkëpunimit me Komunën e Vaxjo-s nga Suedia, në fushën e ndërmarrësisë, duke garantuar parimin e përfitimeve të dyanshme në mes të këtyre dy komunave.
3. Ky komitet do të realizojë vizita sipas nevojës në Komunën e Vaxjo-s për të inicuar dhe realizuar bashkëpunim sa më të suksesshëm në këtë fushë, për të cilën do të arrihen pajtime të ndërsjella.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr.1058/15 dt.09.10.2015.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nga një kopje e këtij Vendimi iu dërgohet:  
-Anëtarëve të Komitetit;  
-Koordinatorit nga Komuna e Vaxjo-s;  
-Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E VUSHTRRI - OPŠTINA VUŠTRIN

03 Nr. / Br. 785/16

Nr. i fq. / Br. sht. -1-

Data / Datum 12.08.2016

VUSHTRRI - VUŠTRIN



**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**

**Kryetari**

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës të datës 12 gusht 2016 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës me datën **12 gusht 2016** merr këtë:

**VENDIM**

1. Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në shumën prej katërqind (400) euro nga fondi për transfere dhe subvencione për OJQ-në "Lëvizja Koha", të cilën e përfaqëson z. Qëndrim Uka, me qëllim të organizimit dhe realizimit të kampit një javor, ku do të marrin pjesë 27 vajza nga Vushtrria, dhe do të ndjekin trajnime të ndryshme.
2. Paguesa e mjeteve financiare të përmendura në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës  
  
Bajram Mulaku



Nga një kopje e këtij Vendimi iu dërgohet:  
-Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;  
-Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;  
-Arkivit të Sekretarisë.





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOMUNALE  
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUŠTRRI  
793 / 16  
- 2 -  
18. 08. 2016  
VUSHTRRI - VUŠTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

#### PËR FORMIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR VEPRIMTARI DITORE PËR PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA

1. Formohet Këshilli komunal për Veprimtari Ditore për persona me nevoja të veçanta.
2. Këshilli komunal për Veprimtari Ditore ka këtë përbërje:
  - 2.1. Abdullah Klinaku, DSHPS, Kryesues
  - 2.2. Shpresa Rama, DKRS
  - 2.3. Musaj Tërbunja, DKA
  - 2.4. Arta Haxhaj, DBPZHE
  - 2.5. Isak Hyseni, Handi-Kos
  - 2.6. Tahir Krasniqi, shtëpia në komunitet në Lum të Madh.
  - 2.7. Violeta Pllana, QPS
3. Veprimtaria ditore për persona me nevoja të organizohet nga ky Këshill si organizim unik i cili ushtrohet në institucionet komunale, në organizatat jo qeveritare dhe në bizneset private.
4. Këshilli komunal e organizon veprimtarin ditore për persona me nevoja të veçanta si në vijim:
  - 4.1. Veprimtarin ditore për personat me nevoja të veçanta që janë rezident në shtëpinë në komunitet në Lum të Madh.
  - 4.2. Veprimtarin ditore për persona me nevoja të veçanta në organizatat që merren në mënyrë aktive me persona me nevoja të veçanta.

- 4.3. Veprimtarin ditore në aktivitetet rekreative.
  - 4.4. Veprimtarin ditore në aktivitete kulturore e artistike.
  - 4.5. Veprimtarin ditore në aktivitetet arsimore e shkollore.
  - 4.6. Veprimtarinë ditore në aktivitetet e lira si pastrim ambienti, gjelbërim dhe angazhime të tjera në pajtim me ligjet në fuqi.
5. Veprimtaria ditore organizohet në pajtim me programet e veçanta që hartohen dhe miratohen nga Këshilli komunal për veprimtari ditore dhe njësit përkatësi që merren më këto kategori.
  6. Këshilli komunal formohet për periudhën kohore 2016-2017.
  7. Këshilli komunal mban mbledhje të rregullta mujore për të cilat mbahet procesverbal nga zyrtari ligjor i DSHPS-së.
  8. Këshilli komunal harton një dokument të brendshëm kur përcakton detyrat dhe përgjegjësit shtesë të tij, të cilin ja dorëzon Kryetarit të Komunës për aprovim.
  9. Këshilli komunal i raporton rregullisht Kryetarit të Komunës.
  10. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
  11. Vendimi ju dërgohet: anëtarëve të këshillit lokal, dhe arkivit të sekretarisë



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku